



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:223855  
Datë: 03.06.2022  
Numri i dokumentit: 03094412

**K. Nr. 1003/21**

**Gjykata Themelore Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni për Kundërvajtje,** Gjyqtari Menderes Behluli, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit S.I nga fsh. ....K. Gjilan, për shkak të veprës kundërvajtëse të paraparë dhe sanksionuar me dispozitat e nenit 36 paragrafi 7, të Ligjit mbi Pyjet nr- 2003/3, Ligjit nr-2004/29 dhe nenit 14, të Ligjit nr., 03/L 153/2010, mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr, 2003/3 për Pyjet e Kosovës i Kuvendit të Kosovës, e konform nenit 55 pika 1 dhe 2, 86, 119, dhe 124, të Ligjit mbi Kundërvajtjet, me datë **03.06.2022** shpallë këtë:

## **A K T G J Y K I M**

Kundër të pandehurit S.I nga babai....., i lindur me datë....., në fsh..... K. Gjilan, ku edhe jeton, shqipëtar, shtetas i Republikës së Kosovës.

## **Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S**

Sepse me datën **12.09.2021** rreth orës **18:12min**, është takuar nga policia e Kosovës stacioni policor-Zhegër, në territorin e fshatit ..... në vendin e quajtur “....”, duke transportuar dru të njoma bunge, në mënyrë ilegale, me diametër 12-14 cm, dhe gjatësi 1 m, me vëllim 1.20 m<sup>3</sup>, në vlerë prej 153.60 euro, të cilat i transportonte me traktor “.....” me ram.

- me ç ‘veprim ka kryer veprën kundërvajtëse, të paraparë dhe sanksionuar me dispozitat e nenit 36 paragrafi 7, të Ligjit mbi Pyjet nr- 2003/3, Ligjit nr-2004/29 dhe nenit 14, të Ligjit nr. 03/L 153/2010, mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr, 2003/3, për Pyjet e Kosovës i Kuvendit të Kosovës, andaj

## **D Ë N O H E T**

Me dënim me gjobë në larësi prej **100 (njëqind) €**, të cilën gjobë i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë në kuptim të nenit 163p. 3 të LK.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor t'i paguajë kësaj gjykate shumën prej **5 €**, në afat të njëjtë sikurse gjobën, konform nenit 109 paragrafi l pika 6, të LMK-së.

Nga një kopje e aktgjykimit t'iu dorëzohet palëve në procedurë.

## **A r s y e t i m**

**A.P.K-ja, në Gjilan**, me datën **22.09.2021**, ka paraqitur kërkesën me nr. **167/21**, për inicimin e procedurës kundërvajtëse, kundër të pandehurit të lartshënuar dhe ka kërkuar që i njëjti të shpallet fajtor dhe ndëshkohet sipas ligjit.

Gjyqtari shqyrtoi kërkesën dhe konstatoi se e njëjta është e ligjshme.

Gjyqtari për vërtetimin e gjendjes faktike mori në pyetje edhe personin zyrtar, pylltarin Osman Isufi, në cilësinë e dëshmitarit i cili deklaroi se është e vërtetë se me dt. **12.09.2021**, në orën **18:12 min**, të lartpërmendurin e ka takuar policia e Kosovës patrulla e Zhegrës, në territorin e fshatit Muqibabë, në vendin e quajtur ".....", duke transportuar dru të njoma bingu, me diametër 12-14cm, me gjatësi 1 m, me vëllim 1.20m<sup>3</sup> me vlerë **153.60** euro, dhe mbetet pran fletëparaqitjes të ushtruar me shkrim

Andaj gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, deklaratës së të pandehurit dhe deklaratës së dëshmitarit erdhi në përfundim se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë prova të mjaftueshme, se i pandehuri është kryerës i veprës kundërvajtës prerje dhe-transportimi ilegal i druve, vepër kjo e paraparë dhe sanksionuar me dispozitat e nenit 36 paragrafi 7, të Ligjit mbi Pyjet nr- 2003/3, Ligjit nr-2004/29 dhe nenit 14, të Ligjit nr. 03/L 153/2010, mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr, 2003/3 për Pyjet e Kosovës të aprovuar nga Kuvendit i Kosovës, për të cilën të njëjtin e shpalli përgjegjës dhe e ndëshkoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari me rastin e shqiptimit të dënimit, pati parasysh peshën dhe pasojat e veprës kundërvajtëse, rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 31 p 1 të LMK-së, dhe të njëjtit i shqiptoi këtë dënim nën minimumin e paraparë ligjor konform nenit 35 të LMK-së, me bindje se edhe me një dënim të këtillë do të arrihet efekti i dënimit tek i pandehuri që në të ardhmen mos të kryej vepra të tilla kundërvajtëse .

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor t'i paguajë kësaj gjykate shumën prej **5 €**, në afat të njëjtë sikurse gjobën, konform nenit 109 paragrafi l pika 6, të LMK-së.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Numri i lëndës: 2021:223855  
Datë: 03.06.2022  
Numri i dokumentit: 03094412

**Gjykata Themelore Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm**  
**Divizioni për Kundërvajtje,**  
**Me datë 03.06.2022**

**Zyrtarja Ligjore**  
Erzë Mustafa

**Gjyqtari**  
Menderes Behluli

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit Divizioni për Kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate.